



Npi – 01/157 datë: 09.07.2020

Duke u bazuar në nenet 12.2 pika (d) dhe 17 pika (l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Ligji Nr. 03/L-164, dt.04.2010 për financimin e programeve të veçanta të banimit; Udhëzimi Administrativ për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, Nr.22/2010, dt.18.11.2010; Udhëzimi Administrativ për normat e banimit për programet e veçanta të banimit, Nr.24/2010, dt.18.11.2010; Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më: 09.07.2020, aprovoi këtë:

Programin Komunal Trevjeçar për Banim **2020-2022**

LLOJI I DOKUMENTIT: PROGRAMI KOMUNAL PËR BANIM 2020-2022

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

VENDIMI: Nr/735 , datë 27.11.2019

GRUPI PUNUES - KOMISIONI PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM:SHTIME

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Drejtoria	Përgjegjësia në Komision
1	Ibrahim Demiri	ZKKK	Kryesues
2	Adelina Beqaj	QPS	Anëtar
3	Arben Lami	DPUKGJ	Anëtare

4	Gojart Bajrami	DSHP	Anëtar
5	Filloreta Isufi	QPS	Anëtare

Ndihma për këtë program është dhënë nga organizata Developing Together në kuadër të projektit “Rritja e kapaciteteve dhe vetëdijes lidhur me të drejtën për banim” mbështetur nga Programi Angazhimi për Barazi- E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar- USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim- ATRC

Përmbajtja

HYRJE.....	5
VIZIONI.....	5
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	5
KORNIZA LIGJORE	6
DOKUMENTET E TJERA RELEVANTE.....	6
PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT	7
VENDIMET SHITESË PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT.....	7
STRATEGJITË E NIVELIT QEVERITAR.....	8
PROFILI I KOMUNËS SË SHITES.....	8
POZITA GJEOGRAFIKE	8
KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE TË SHITES.....	9
MIGRIMI	9
POPULLSIA - sipas regjistrimit të vitit 2011	10
SHTIMI NATYROR.....	10
JETËGJATËSIA.....	10
ARSIMI	12
ANALIZË EKONOMIKE	12
BUJQËSIA.....	13
PAPUNËSIA	14
TËARDHURAT	14

TË ARDHURAT MESATARE-GJENDJA SOCIALE.....	14
EKONOMIA/ POTENCIALI I KOMUNES	15
PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA.....	15
ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL	16
OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL.....	16
FAMILJET MOMENTALISHT TE NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL	16
KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL	16
KATEGORITË E SYNUARA.....	17
KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË.....	17
GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE	18
PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL	19
NDËRTIMI I NJË NDËRTESE PËR BANIM SOCIAL ME 16 NJËSI BANESORE	19
SIGURIMI I BANIMIT PËR 25 FAMILJE PËRMES BONUS BANIMIT.....	21
IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT	21
Caktimi i zyrtarit për banim.....	22
Ndarja e buxhetit për Banim Social.....	Error! Bookmark not defined.
Mënyra e implementimit e skemave për Bonus Banim.....	23
REZULTATET PAS ZBATIMIT	24
Instrumentet e mbikqyrjes.....	24
Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve	24
Masat që janë marrë për respektimin e kuadrit ligjor.....	25
Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit te transperencës.....	25
ANALIZA SWOT	26

HYRJE

E drejta për banim është njëra ndër të drejtat themelore të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe me Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga aspekti social, banimi adekuat është një e drejtë themelore e njeriut ndërsa nga aspekti i planifikimit hapësinor/urban banimi konsiderohet si shfrytëzues më i madhi i hapësirës. Si çështje sociale dhe çështje e planifikimit strategjik të një vendi, adresimi i çështjes së banimit në mënyrë të duhur siguron zhvillim social dhe ekonomik të qëndrueshëm.

Në këtë kontekst qasja në banim është një disiplinë multisektoriale, mjaft komplekse që kërkon nga autoritetet qendrore dhe komunale përkushtim dhe vullnet politik për të adresuar me kompetencë këtë çështje.

Me miratimin e Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit (03/L-164) i është dhënë një kornizë më e avancuar autoriteteve vendimmarrëse lokale për të ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Kosovës.

Sigurimi i Banimit është bazë për funksionalizimin e familjes, shoqërisë por edhe vet shtetit, si për nga stabiliteti psiko-social ashtu edhe ekonomik. Andaj me këtë program pretendojmë që të vendosim rend në adresimin e çështjeve të banimit në komunë për të ofruar banim me qira jo profitabile për kategoritë e popullatës që nuk kanë fuqi ekonomike për të paguar qera në tregun e lirë të banesave.

VIZIONI

Komuna e **Shtimes** të jetë një vend me kapacitete gjithëpërfshirëse të ndërtimit dhe banimit, atraktiv dhe mbështetës për kategori të caktuara, me një popullsi aktive dhe nivel të lartë të kualitetit të jetës dhe kulturës për të gjitha komunitetet.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i këtij programi është krijimi i kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë mundësi ekonomike që vetë ta zgjidhin problemin e banimit.

KORNIZA LIGJORE

Programi Trevjeçar për Banim është bazuar në legjislaturën si në vijim:

- Ligji Nr. 03/L-164, dt.04.2010 për financimin e programeve të veçanta të banimit;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e Kontratës për banesën me qira jo profitabile, Nr.10/2010 dt.2.09.2010;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e bonusit të banimit, Nr.19/2010-dt.02.09.2010;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, Nr.22/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për normat e banimit për programet e veçanta të banimit, Nr.24/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit, Nr.23/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Nr.21/2010, dt. 18.11.2010;
- Ligji 04/L-134 të ndërtesës në bashkëpronësi, dt.06.09.2013;
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dt.19.06.2008;
- Ligji nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, dt.27.01.2012;
- Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit;
- Statuti i Komunës;
- Dokumentet planore - urbane;
- Ligji për Procedurat Administrative, 05/L-031, dt.21.06.2017.

DOKUMENTET E TJERA RELEVANTE

Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit;


Plani Zhvillimor Komunal (2008 - 2018);

Plani Zhvillimor Urban (2008 - 2018);

Plani Rregullues Urban;

Ligji për Procedurat Administrative 2005/02-L28.

PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT



VENDIMET SHITESË PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT

Vendimet shtesë për përpilim të Programit Trevjeçar për Banim janë si në vijim:

- Vendimi i Kryetarit të Komunës së Shtimes datë 27.11.2019, për përgatitjen e Projektit të Programit të Veçantë për Banim në Komunën e Shtimës për Periudhën 2020-2022;
- Sigurimi i të dhënave nga fushat përkatëse të Komunës (Drejtoria e Arsimit, Qendra për Punë Sociale, Zyra për Komunitete, Qendra për Punësim etj);
- Identifikimi i grupeve të synuara;
- Kategorizimi i grupeve dhe klasifikimi i kërkesave për përcaktimin e radhës së përparësisë bazuar në gjendjen faktike të çështjes së banimit;
- Struktura e Buxhetit Komunal në Shtime;
- Përgatitja e dokumentit;
- Bërja publike e Programit Trevjeçar të Banimit - informimi;
- Procedurat e miratimit të dokumentit;
- Aprovimi nga Kuvendi i Komunës;

Në përpilim të programit ka ndihmuar edhe OJQ Developing Together.

STRATEGJITË E NIVELIT QEVERTAR

- Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 dhe plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021
- Strategjia Kombëtare për Ri-integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2018-2022.
- Strategjia për Komunitete dhe Kthim.

PROFILI I KOMUNËS SË SHTIMES

Në vijim janë të prezantuara disa informata bazike lidhur me komunën e Shtimes

POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Shtimes shtrihet në skajin perëndimor të Rrafshit të Kosovës. Në komunën e Shtimes, duke e veçuar qytetin e Shtimes, janë përqëndruara shumë qendra administrative, kulturore, arsimore dhe shëndetësore, si dhe të objekteve komerciale.

Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, apo në koordinatat 42.433E, 21.038N. Territori i komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134.22 km² (13,422.8 hektarë), gjegjësisht, 1,2 % të territorit të Kosovës.

Komuna e Shtimes sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, në vitin 2011, numëron rreth 27,324 banorë, ku rreth 73.8 % e popullatës jeton në fshatrat e komunës. Komuna ka 23 vendbanime duke përfshirë qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore - malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore.

Komuna e Shtimes kufizohet, në verilindje me komunën e Lipjanit, në perëndim me Therandën dhe në jug me komunën e Ferizajt.

KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE TË SHTIMES

Në bazë të të dhënave të marra nga regjistrimi i popullsisë së vitit 2011, publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, shihet se numri i popullsisë në komunën e Shtimes është 27,324 banorë ku prej tyre 13,850 janë të gjinisë mashkullore ndërsa 13,474 janë të gjinisë femërore¹. Dendësia e popullsisë 202 b/km², rreth 21% më e lartë se mesatarja e popullsisë në Republikën e Kosovës e cila është 159.36 b/km².

MIGRIMI

Duke u mbështetur në shënimet e Agjencionit për Statistikat e Kosovës gjejmë se në Komunën e Shtimes Migrimi është si vijon: 3,265 meshkuj dhe 2,577 femra e që në totalë shtë 5842² banorë, ky numër i Migrimit shihet se është i shtrirë në të gjithë botën, por numri më i madh i Emigrantëve është i përqendruar kryesisht në Gjermani dhe Zvicër.

Tabela Nr. 3 . Gjithsej, popullsia e Komunës së Shtimes në vitin 2014 dhe migrimi për vitin 2015³

Komuna	Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2014)	Migrimi ndërkombëtar (2015)			Migrimi kombëtar (2015)			Bilanci i përgjithshëm i migrimit në nivel komune 2015	Gjithsej popullsia dhe migrimi (01.01-31.12 2015)
		Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit ndërkombëtar 2015	Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit kombëtar		
Shtime	27,818	291	1,213	-922	146	167	-21	-943	26,875

Nëse marrim si shembull Tabelën për të nxjerr një statistikë shohim se popullsia e Komunës së Shtimes ka zvogëlim të popullsisë në vitin 2015 për 3.4%, në krahasim me vitin 2014 si rezultat i Migrimit.

POPULLSIA - sipas regjistrimit të vitit 2011

Nacionaliteti	Numri i banorëve	Përqindja
Shqiptar	26,447	96.79 %
Serb	49	0.18 %
Turq	1	0.00 %
Boshnjak	20	0.07 %
Rom	23	0.08 %
Ashkali	750	2.74 %
Egjiptian	0	0.00 %
Goran	2	0.01 %
Të tjerë	13	0.05 %

SHTIMI NATYROR

Burimet e Agjencionit për Statistikat e Kosovës tregojnë se shtimi natyror për vitin 2015 është 363 banorë, nataliteti është 485 banorë dhe mortaliteti 122 banorë për Komunën e Shtimes⁴. Burime spitalore dhe burime të tjera tregojnë se lindjet e periudhës 1990 deri 2014 tregojnë se numri i lindjeve në Kosovë është në rënie të vazhdueshme. Kjo rënie e lindshmërisë është si pasojë e rënies së vazhdueshme ekonomike dhe rritjes së varfërisë dhe pasigurisë në prosperitet dhe zhvillim ekonomik.

Për Shtimen nuk posedojmë shënime të sakta por numri i lindjeve në 1000 banorë duhet të sillet aty rreth 15 lindje, që konsiderohet shtim mjaft i vogël, krahasuar me vitet '70-ta që ka qenë 37.5 lindje.

JETËGJATËSIA

Pasi që për Komunën tonë nuk posedojmë statistika për jetëgjatësinë, atëherë marrim për bazë mesataren e jetëgjatësisë në Kosovë e cila tregon se: “Si hipotezë pune, ne supozojmë se jetëgjatësia në lindje në vitin 2011 ishte 74.1 vjet për burra dhe 79.4 vjet për gra. Jetëgjatësia mesatare (për dy gjinitë) për vitin 2011 ishte 76.7 vite”⁵.

Statistikat tregojnë se popullsia kosovare jeton mesatarisht diku rreth 69 vite. Afërsisht jetëgjatësia e popullsisë është e njëjtë edhe në Shtime.

Mendojmë se niveli i zhvillimit nuk mund të matet vetëm në bazë të të ardhurave, por duhet të merren parasysh edhe disa tregues të zhvillimit si: jetëgjatësia, arsimimi-shkalla e arsimimit të të rriturve, regjistrim në shkolla, të ardhurat për kapital, etj.

- Jetëgjatësia, është një prej treguesve të rëndësishëm. Kjo ka të bëjë me jetën e njerëzve, sa dhe si i përdorin burimet financiare në të mirë të përmirësimit të kushteve shëndetësore, ushqimit dhe standardit të jetës, nga këto të dhëna llogaritet treguesi i jetëgjatësisë.
- Prodhimi i brendshëm bruto, pasqyron të ardhurat mesatare për kapital, të llogaritura për fuqi blerëse, kjo na mundëson llogaritjen e treguesve të të ardhurave.

Tabela Nr. 4 . treguesi i zhvillimit njerëzor ⁶

Komuna	Prishtina	Shtime	Kosovë
Jetëgjatësia	71	64	69
Arsimi	96	96	94
Regj. në shkollë	91	89	88
Të ardhurat për kapital	1586	623	1053
Treguesi i jetëgjatësisë	0.77	0.66	0.73
Treguesi i arsimimit	0.94	0.93	0.92
Treguesi i të ardhurave	0.46	0.30	0.39
Treg. i zhvill. njerëzor	0.72	0.63	0.68

Treguesi i zhvillimit njerëzor është një kombinim i treguesit të jetëgjatësisë, treguesit të arsimimit dhe treguesit të të ardhurave. Kjo llogaritje për herë të parë është aplikuar në Kosovë nga UNDP, në vitin 2004, ku ka dalë se Kosova ka treguesin e zhvillimi njerëzor në koeficientin prej 0.68, ku janë marrë parasysh treguesi i jetëgjatësisë prej 0.73, treguesi i arsimimit prej 0.92 dhe treguesi i të ardhurave prej 0.39 dhe nga këta koeficient ka rezultuar se Kosova renditet në mesataren e vendeve me zhvillim mesatar njerëzor. Bazuar në këto burime të UNDP-së Shtimja është pak nën mesataren e Kosovës.

ARSIMI

Në komunën e Shtimes kemi gjithsej 8 Institucione Arsimore që zhvillojnë mësimin nga klasa përgatitore deri në klasë nëntë, 2 shkolla të mesme të larta njëra me drejtime të Gjinnazit ndërsa tjetra Shkollë e Mesme e Lartë Profesionale si dhe një Institucion Parashkollor.

SHKOLLAT	Nr. i nxënësve
SHF "Abdullah Shabani"- Carralevë	173
"Abdullah Shabani"- Zborc	166
SHF "Bajram Curri"- Petrovë	378
"Bajram Curri"- Mollopolc	113
"Emin Duraku" - Shtime	1532
"Emin Duraku" - Davidovc	148
"Emin Duraku" - Belinc	76
"Emin Duraku" - Lagje e Pajtimit	80
"Hasan Prishtina"-Godanc	426
"Idriz Ajeti" - Pjetërshticë	238
"Idriz Ajeti" - Karaqicë	3
"Lasgush Poradeci" - Muzeqinë	229
"Lasgush Poradeci" - Vojnovc	164
"Lasgush Poradeci" - Rashincë	141
"Lasgush Poradeci" - Gjyrkoc	146
"Lasgush Poradeci" - Gllavicë	27
"Skenderbeu" -Reçak	279
SHM. "Naim Frashëri"- Shtime	666
Shkolla Profesionale - Shtime	518
IP."Albiona Asllani" - Shtime	45
Gjithsej	5561

ANALIZË EKONOMIKE

Resurset ekonomike dhe burimet njerëzore të Shtimes janë shumë të favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm dhe prosperitet ekonomik, sidomos në bujqësi dhe turizëm.

Në Komunën e Shtimes operojnë, tash për tash, rreth 1700 biznese. Sipas strukturës bizneset janë në:

Tregti,
Transport,
Prodhim,
Bujqësi
Ndërtimtari,

Arsim,
Zejtari,
Hotelier ,
Shëndetësi,
Financa,
Shërbyese

BUJQËSIA

Bujqësia është një ndër lëmitë kryesore në të cilën duhet të investohet. Bujqësia duhet të jetë bartëse e zhvillimit të ardhshëm të komunës, ngase për të ekzistojnë kushte të volitshme.

Komuna e Shtimes posedon tokë pjellore, klimë të përshtatshme dhe traditë punuese në bujqësi gjë që ka bërë të ketë rendimente të kënaqshme. Vëmendje të veçantë duhet kushtuar ruajtjes së tokës bujqësore, përveç rasteve kur stimulohet prodhimi bujqësor.

Komuna posedon 6697 hektarë tokë bujqësore, prej të cilave 4947 hektarë janë tokë pjellore.

Nr	Vendbanimi	Sipërfaqja e tërë ha	SIPËRFAQET BUJQËSORE						Pyje ha
			Gjithsej: ha	Sipërfaqet punuese					
				Gjithsej ha	Ara dhe kopshte ha	Pemishte Ha	Livadh e ha	Kullosa ha	
1	Belinc	631.7	140,6	109,3	101,8	1,7	5,8	31,3	459,0
2	Zotaj	456,5	428,8	418,4	373,8	0,1	44,5	10,4	428,8
3	Davidovc	246,8	229,2	212,0	152,4	1,9	57,7	17,2	-
4	Godanc i P.	525,4	401,8	357,2	346,1	3,1	8,0	44,6	91,7
5	Gjergjaj	365,3	344,1	318,2	288,9	-	29,3	25,9	-
6	Zborc	579,5	198,8	176,3	155,7	5,0	15,6	22,5	328,7
7	Llanisht	281,1	71,0	46,7	26,6	1,1	19,0	24,3	203,5
8	Mollopolc	703,6	147,5	120,9	96,2	2,9	21,8	26,6	538,0
9	Muzeqinë	603,9	568,2	535,9	505,9	7,5	22,5	32,3	-
10	Lagjja e Paj.	320,5	364,3	334,6	312,6	2,0	19,8	29,7	-
11	Petrovë	1266.5	233.3	179.6	162.1	6.6	10.9	53.7	989.5
12	Ranca	433.6	92.2	73.4	48.5	4.2	20.71	18.8	330.3
13	Raçaku	442.6	163.6	114.7	90.7	11.3	12.4	48.9	249.1
14	Rashinca	553,9	489,3	436,9	418,0	6,0	12,9	52,3	-
15	Topillë-Deve.	1627.9	421.5	299.1	160.6	0.6	137.9	122.4	1165.9
16	Carralevë	1076.7	301.3	192.8	152.8	7.3	32.7	108.5	713.9
17	Godanci i E	564.7	237.0	221.8	209.1	1.0	11.5	15.2	296.8
18	Dugë	257.2	99.9	39.6	30.1	0.9	8.6	60.3	149.2
19	Karaqicë	220.3	152.4	96.4	51.9	1.1	43.9	55.5	58.9
20	Pjetërshticë	1009.8	330.7	226.6	188.6	6.6	31.4	104.1	644.5
21	Shtime	1283.3	1094.5	962.5	632.9	264.1	64.7	132.0	105.0
Komuna në tërësi		13450.8	6510	5472	4505	335	631.5	1037	6377.8

PAPUNËSIA

Sipas hulumtimit të të dhënave për komunën e Shtimes për secilin vendbanim, kemi vënë re se papunësia e lartë është një prej sfidave më shqetësuese për popullatën e kësaj ane. Sipas të dhënave të analizuara për numrin e punëkërkesve, në këtë territor kemi të bëjmë me tri kategori të papunëve; a) të papunët e përkohshëm, b) të papunët afatmesëm dhe c) të papunët e përhershëm. Në kategorinë e parë të papunëve hynë të papunët e përkohshëm, të cilët kohë pas kohe merren me bujqësi, blegtori apo ndonjë aktivitet të përkohshëm. Në kategorinë e dytë janë të papunët afatmesëm, të cilët kryesisht gjatë stinës së dimrit mbesin pa punë, për shkak të temperaturave të ulëta, që pamundëson kryerjen e punëve ndërtimore. Ndërsa, në grupin e të papunëve të përhershëm hynë njerëzit me moshë të shtyrë mbi pesëdhjetë vjet.

TËARDHURAT

Sipas disa llogaritjeve të përafërta dhe empirike, të ardhurat për kokë banori në komunën e Shtimes janë rreth 209 € në muaj, vlerë kjo e cila është më e ulët se mesatarja e të ardhurave mujore për kokë banori në Kosovë, e cila duhet të sillet diku rreth 374 € në muaj.

TË ARDHURAT MESATARE-GJENDJA SOCIALE

Numri i familjeve përfituese të asistencës sociale	
Periudha	Numri i familjeve
2010	583
2011	553
2012	537
2013	517
2014	488
2015	419
2016	408
2017	412
2018	396
2019	375
2020	375

EKONOMIA/ POTENCIALI I KOMUNES

Tabela: Buxheti i planifikuar 2020- 2022

Lloji i Granteve	2020	2021	2022
1. Granti i përgjithshëm	2,932,782	3,090,928	3,270,979
2. Granti për arsim	3,311,815	3,328	3,345,006
3. Granti për shëndetësi	893,463	929,202	966,370
4. Sherbime rezidenc.	170,000	170,000	170,000
5. Të hyrat vetanake	629,651	704,132	778,568
TOTALI	7,937,711	8,222,636	8,530,923

PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA

Nr.	Zonat - territori i mbuluar me plane urbane	Sipërfaqja totale e Komunës /ha	Sipërfaqja e zonës me PU	Raporti %
1.	Qyteti i Shtimes dhe rrethina e ngushte me PRRU, PZHK, PZHU	13422	13422 ha	100%
2.	Vendbanimet PRRU	13422	1531 (zona urbane)	11.40%
3.	Vendbanimet PZHK dhe PZHU	13422	13422	100%

Bazuar në të dhënat nga Plani Rregullues Urban për zonat urbane janë definuar rregullat e shfrytëzimit të tokës – parametrat urban si: ISHP max = 40%, 50%, banimi kolektiv , banimi individual, afarizmi dhe zonat ekonomike. Në kuadër të PZHK dhe PZHU janë definuar përmbajtjet për zonat dhe vendbanimet, kështu që në kuadër të zonave banimore , fokusohen zonat e caktuara për zhvillimin e banimit sipas programeve, si Zona ne Davidovc, Belinc-Carralevë, Lagje e Pajtimit dhe Shtime si potencial për zhvillimin e programeve të banimit. Zonat e tilla do të jepen pjesë e zonave ekzistuese të banimit.

ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL

Në vijim do të prezantohet gjendja aktuale lidhur me objektet në pronësi të komunës të dedikuara për banim social si dhe numri/profili i familjeve tani më të ndihmuara me sigurim të banimit. Po ashtu do të prezantohet kërkesa aktuale për banim në komunën e Shtimes.

OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL

Në komunën e Shtimes nuk ekziston asnjë ndërtesë në pronësi komunale e cila do të mund të përdorej për Banim Social.

Kjo konsiderohet si një mangësi për komunën e Shtimes dhe e vështirëson shumë mundësinë për ndihmë për familjet në gjendje të rëndë socio ekonomike të cilat kanë nevojë për banim të përkohshëm.

FAMILJET MOMENTALISHT TE NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL

Komuna e Shtimes i ndihmon familjet në nevojë për banim kryesisht duke i përkrahur familjet të cilat jetojnë në shtëpitë e tyre dhe kanë nevojë për riparime siç janë ndërrimi i dyerve apo dritareve si dhe riparim të nyjeve sanitare.

Për shkak të mungesës së ndërtesave komunale për banim social, komuna e Shtimes deri më tani ka qenë në pamundësi që të ndihmoj familjet me skemat e parapara me ligjin për financimin e programeve të veçanta për banim.

Në komunën e Shtimes mungon linja buxhetore e veçantë për banim si dhe mungon zyrtari për Banim Social.

Përmes këtij programi, komuna e Shtimes planifikon që ta përmirësoj këtë situatë.

KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL

Në komunën e Shtimes në vazhdimësi vijnë kërkesa për ndihmë për banim. Kërkesat bëhen përmes formularit sipas Udhëzimit Administrative Nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta për banim. Këto kërkesa shqyrtohen nga zyrtarë komunal nga drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe nga Zyra për Komunitete dhe Kthim. Kërkesat kanë të bëjnë kryesisht me nevoja për renovime dhe riparime në shtëpi të vjetra apo të dëmtuara. Komuna e Shtimes i viziton këto familje dhe në bazë të buxhetit në dispozicion dhe në bazë të nevojave të qytetarëve e bën shpërndarjen e ndihmave.

Për momentin në komunën e Shtimes janë të evidentuara 60 familje të cilat kanë nevojë për ndihmë në banim.

Nga ky numër 35 familje kanë nevojë për ndihmë për renovim apo riparim ndërsa 25 familje kanë nevojë për banim social.

Të gjitha këto familje janë të evidentuara. Momentalisht nuk janë vendosur në data bazë. Të gjitha këto familje do të regjistrohen në data bazë siç do të përshkruhet në pjesët e planifikimit të prezantuar në pjesët e mëposhtme të këtij programi.

GJENDJA E PROGRAMEVE TREVJEÇARE TE VEÇANTA PER BANIM NE KOMUNAT E KOSOVES 2020							
N r	Komuna	Periudha Kohore	Numri i kërkesave sipas kategorive				
			Rastet sociale	Rom ashkali egjiptian	F. e dëshm. dhe inval.	Të kthyerit	Të riatdhes.
	Shtime	2020-2022	12	12			1

KATEGORITË E SYNUARA

Kategorizimi dhe specifikimi do të rregullohet sipas bazës ligjore duke i definuar balancën ndërmjet kategorive të synuara nëpër vite të aplikimit sipas të cilit do të përcaktohen kriteret e caktuara për familjet përfituese të cilat do të kenë për bazë: karakteristikat sociale dhe ekonomike të familjeve që presin ndihmën nga autoritetet komunale për të zgjidhur problemet e banimit.

Ndër kategoritë që do të përfitojnë nga programet e banimit parashihen:

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.
- Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politik;
- Të kthyerit dhe komunitetet RAE (minoritetet)
- Të riatdhesuarit
- Të moshuarit
- Të rinjtë
- Të punësuarit nga buxheti shtetëror
- Nënata vetushqyese-kryefamiljare

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

Statusi i banimit;

Lartësia e të ardhurave;

Gjendja shëndetësore;

Invaliditeti;

Struktura e familjes;

GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE

KOMUNA E SHTIMES			
Nr. i popullsisë		27,324	
Zonat rurale		20,217	
Zonat urbane		7,107	
Nr. i fshatrave/nr i lagjeve		22+1+5=28	
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999	4096	
	Nr. objekteve pas 1999	8802	
	Etazhiteti mesatar	B+ P+1	
Banimi kolektiv			
	Pas 1999	Nr. Objekteve	0
		Nj. Banimi	0
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]		100 /0%	
Kycje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]		100%	
Nr. i objekteve të pabanuara		0	
Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim		0	
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]		50%	
	Mbindërtimet	0	
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit		60	
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit		0.25 ha	
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët (shtëpi individuale)		0 11 shtëpi në vitin 2019	
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qirasë		0	
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponushëm për qira të ulëta të tregut		0	
Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që duhet të rinovohen		0	
Qendrat përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK	0	
	Vendndodhja /emërtimi	0	
	Nr. i familjeve	0	
	Nr. i banorëve	0	
Planet e reja rregulluese janë në hartim e sipër		Zona urbane e kompletuar 100%. Nevojiten edhe 3 plane rregulluese të parapara me PZHK-në	

PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL

Programi për banim i Komunës së Shtimes është hartuar për periudhën 2020-2022. Komisioni i formuar nga ana e kryetarit të komunës me ndihmën e OJQ Developing Together ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e komunës së Shtimes që nuk kanë mundësi të sigurojnë kulm mbi kokë.

Duhet të konstatohet që në komunën e Shtimes ka mjaft hapësirë për përmirësimin e ndihmës për familjet në nevojë për banim social gjë që synohet të bëhet me këtë program.

Përpos ndihmës konkrete për qytetarët e vet, brenda kësaj periudhe tre-vjeçare do të vazhdohet me analiza për të emëruar zyrtarin e banimit në kuadër të komunës së Shtimes i cili i mungon komunës sonë.

Pra, Programi i prezantuar Trevjeçar për Banim i ka tri objektiva:

- Ndërtimi i një ndërtese për Banim Social me 16 njësi banesore;
- Sigurimin e banimit për 25 familje përmes skemës së Bonus Banimit;
- Emërimin e zyrtarit për banim social;

NDËRTIMI I NJË NDËRTESE PËR BANIM SOCIAL ME 16 NJËSI BANESORE

Një ndër prioritetet kryesoretë këtij programi është që në periudhën tre vjeçare edhe komuna e Shtimes si shumë komuna të tjera të ketë në pronësi të vet një ndërtesë për nevojat e Banimit Social.

Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Financimin e Programeve Trevjeçare për Banim (03/L-164). Sipas këtij ligji, sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira, ku përfshihen:

- a) banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- b) banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- c) banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Komuna e Shtimes nuk e posedon asnjë ndërtesë në pronësi të vet e cila do të mund të përdorej për nevojat e qytetarëve për banim të përkohshme përmes skemave të banimit social.

Kjo gjendje duhet të ndryshojë.

Meqenëse siç u përmend edhe më lartë për momentin kanë aplikuar 25 familje në nevojë për banim social, nga kjo derivon se komuna e Shtimes ka nevojë për një ndërtesë të tillë.

Sipas analizave të komisionit duhet të ndërtohet një ndërtesë për nevojat e Banimit Social. Për nevojat e Komunës së Shtimes komisioni propozon ndërtimin e një ndërtese me 16 njësi banesore.

Parcela për këtë ndërtesë është e planifikuar të jetë në Zonën kadastrale Lagja e Pajtimit, në ngastrën kadastrale Nr.1/2, evidentuar Pronë Shoqërore e Komunës së Shtimes (Vendimi i Kuvendit të komunës Shtime Npi-01/62, datë 19.03.2014) Kjo nuk përjashton mundësinë e marrjes së një Vendimi tjetër nga Kuvendi, në rast se ky lokacion hasë në çfarëdo problemi pasi që është marrë në vitin 2014.

Mesatarja e njërive banesore propozohet të jetë rreth 65 m² një kalkulim i përafërt i vlerës për ndërtimin e kësaj ndërtese është si në vijim:

$$\begin{aligned} 65 \text{ m}^2 \times 16 \text{ njësi banesore} &= 1,040 \text{ m}^2 \\ 1,040 + 12\% \text{ për hapësirat e përbashkëta} &= 1,165 \text{ m}^2 \\ 1,165 \text{ m}^2 \times 280 \text{ €/m}^2 \text{ (vlera e përafërt investive)} &= 326,000 \text{ €} \end{aligned}$$

Pra vlera e përafërt investive llogaritet të jetë rreth 326,000 Euro

Kjo ndërtesë planifikohet të ndërtohet brenda dy viteve 2021/22.

Për këtë qëllim komuna e Shtimes duhet të i ndajë 20% të vlerës investive pra rreth 65,200 Euro ndërsa vlera tjetër prej 80 % o të kërkohet nga Qeveria e Kosovës përmes MMPH'së.

Në formë tabelare investimi për ndërtimin e ndërtesës për Banim Social duket si në vijim.

Invstitorët:	Viti 2021	Viti 2022
Komuna e Shtimes	<i>32,600 Euro</i>	<i>32,600 Euro</i>
Qeveria e Kosovës përmes MMPH'së	<i>130,400 Euro</i>	<i>130,400 Euro</i>
	Totali	<i>326,000 Euro</i>

SIGURIMI I BANIMIT PËR 25 FAMILJE PËRMES BONUS BANIMIT

Një formë tjetër me të cilën komuna e Shtimes planifikon të ndihmojë familjet në nevojë për banim social është përmes banesave ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit.

Në këtë formë Komuna e Shtimes planifikon të ndihmojë 25 familje në tre vitet e ardhshëm.

Në vitin 2020 do të ndihmohen 5 familje. Meqenëse për vitin 2020 nuk ka të planifikuar buxhet të veçantë për këtë qëllim, atëherë për këto 5 familje propozohet që buxheti të sigurohet nga fondit për subvencione.

Buxheti i nevojshëm për tre vitet në vijim është si vijon:

Viti 2020: 8 muaj (Maj - Dhjetor 2020) x 100 €/muaj x 5 familje = 4,000 Euro;

Viti 2021 12 muaj x 100 €/muaj x 10 Familje = 12,000 Euro;

Viti 2022 12 muaj x 100 €/muaj x 10 Familje = 12,000 Euro;

Në total kërkohen 28,000 Euro/tre vite

Kjo formë e ndihmës do të paguhet e tëra nga buxheti Komunal.

Për vitin 2020 sigurimi i mjeteve për Bonus Banim do të bëhet nga linja buxhetore për subvencione ndërsa për vitet 2021 dhe 2022 do të krijohet një nën-kod i ri buxhetor për banim i cili kod do të krijohet nën kodin ekzistues për çështje sociale.

Për këtë do të kërkohet ndihmë nga MMPH dhe Ministria e Financave. Krijimi i këtij nën-kodi si dhe zotimi i mjeteve për realizimin e këtij programi do të iniciohet në pjesën e dytë të vitit 2020 atëherë kur fillojnë planifikimet buxhetore për vitin 2021.

IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT

Komisioni për përpilimin e këtij programi ka qenë mjaft i kujdesshëm që programi të jetë konkret dhe i zbatueshëm. Në këtë drejtim na ka ndihmuar mjaft përvoja e Organizatës Developing Together (DT) të cilët na kanë dhënë mjaft këshilla të vlefshme.

Programi është konkret dhe i zbatueshëm sepse prezanton numra konkretë të familjeve që planifikohen të ndihmohen brenda tre viteve si dhe është bërë kalkulimi i përafërt i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e këtij programi.

Sidoqoftë, komisioni beson se edhe ky program do të mbetet i pazbatueshëm nëse nuk ndërmerren hapa konkretë si në vijim:

Caktimi i zyrtarit për banim

Komuna e Shtimes duhet të caktojë një zyrtar i cili në përshkrimin e vendit të punës do të ngarkohet edhe me trajtimin e çështjes së Banimit Social.

Disa nga detyrat e planifikuara të këtij zyrtari propozohen si në vijim:

- Informimi i qytetarëve lidhur me planet komunale për Banim Social;
- Ofrimi i formularëve adekuat për familjet që kanë nevojë të aplikojnë për Banim Social;
- Regjistrimi i aplikacioneve në bazën e të dhënave për kërkesat për banim social ;
- Krijimi i listës së ngushtë;
- Inicimi i krijimit të komisionit për përzgjedhje të përfituesve;
- Draftimi i kontratave me përfitues;
- Përcjellja e gjendjes së përfituesve;

Ndarja e buxhetit për Banim Social

Ky program rrezikon të mbetet i pazbatuar nëse nuk planifikohet buxhet i caktuar për Banim Social.

Meqenëse ky program është për tre vite, ndarja e buxhetit propozohet si në vijim:

Viti 2020

Për vitin 2020 planifikohet të ndihmohen 5 familje me Bonus Banim (pagesë të gjysmës së qerasë për familje në nevojë për banim të përkohshëm).

Pritet që ky program të miratohet brenda muajit Mars.

Brenda muajit Prill mund të bëhet përzgjedhja e 5 familjeve përfituese të Bonus Banimit prandaj pagesa për Bonus Banim mund të fillon nga muaji Maj 2020.

Për këtë qëllim nevojiten 4,000 Euro. Meqenëse buxheti për vitin 2020 është veçse i planifikuar, propozohet që këto mjete të ndahen nga linja buxhetore për subvencione apo ndonjë linjë tjetër në dispozicion.

Viti 2021

Për vitet në vijim duhet të planifikohet krijimi i një nën-kodi të veçantë buxhetor si pjesë e kodeve për çështje sociale.

Kjo duhet të bëhet në pjesën e dytë të vitit 2020 kur fillojnë planifikimet buxhetore për vitin 2021. Për vitin 2021 buxheti i nevojshëm është si në vijim:

Për bonus banim nevojiten 12,000 euro për të ndihmuar 10 familje me Bonus Banim;

Për ndërtimin e ndërtesës për Banim Social gjatë vitit 2021 duhet të ndahen nga komuna e Shtimes një vlerë prej 32,600 Euro ndërsa nga Qeveria e Kosovës përmes MMPH'së do të kërkohej 130, 400 Euro. Ndarja e buxhetit do të bëhet me Vendim të Kuvendit të Komunës.

Viti 2022

Edhe për vitin 2022 vlera e planifikuar buxhetore do të jetë e njëjtë si për vitin 2021. Pra, për bonus banim planifikohen 12,000 Euro për të ndihmuar 10 familje.

Për përfundimin e ndërtimit të ndërtesës për Banim Social gjatë vitit 2022 duhet të ndahen nga komuna e Shtimes një vlerë prej 32,600 Euro ndërsa nga Qeveria e Kosovës përmes MMPH-së do të kërkohej 130, 400 Euro.

Përmbledhja e nevojave buxhetore në formë tabelare për vite është si në vijim:

	2020	2021	2022	Totali
Komuna e Shtimes për Bonus Banimi	4,000 €	12,000 €	12,000 €	28,000 €
Komuna e Shtimes për Ndërtesë Sociale	0	32,600 €	32,600 €	65,200 €
Qeveria e Kosovës për ndërtesë sociale	0	130,400 €	130,400 €	260,800 €
			Totali	354,000 €

Mënyra e implementimit e skemave për Bonus Banim

Për përzgjedhjen e përfituesve për t'u ndihmuar me Bonus Banim propozohen dy metoda.

Metoda e parë – përzgjedhja direkte e përfituesve;

Kjo mund të bëhet nga lista e familjeve të cilat aplikojnë për ndihmë pa thirrje publike por në mënyrë natyrale të shtyrë nga nevoja për sigurim të strehimit.

Në këto raste zyrtari për banim e bën një listë të ngushtë duke i vendosur të dhënat e aplikuesve në Data Bazë. Familjet të cilat i plotësojnë kriteret për të përfituar Banim Social vizitohen nga një komision komunal i propozuar nga Kryetari i Komunës.

Pas përzgjedhjes së përfituesve, nënshkruhet kontratë me ofruesin e banesës me qira.

Përzgjedhja e ofruesve të banesave me qira bëhet sipas ligjit. Format e kontratës gjenden në Udhëzime Administrative.

Mënyra direkte e përzgjedhjes së përfituesve rekomandohej për vitin 2020 kur në Komunë janë një numër i kërkesave për Banim Social.

Metoda e dytë – përzgjedhja e përfituesve me thirrje publike

Për të ndihmuar familjet në nevojë për banim social, në fillim të vitit, komuna e Shtimes do të shpall konkurs. Përmes konkursit do të përzgjidhen për t'u ndihmuar një numër i caktuar i familjeve në vit. Për këto raste do të vendos komisioni i krijuar për këtë qëllim i udhëhequr nga zyrtari për Banim.

Edhe në këto raste aplikantët vendosen në Data Bazë, krijohet lista e përfituesve potencial që i plotësojnë kriteret dhe vizitohen në terren.

Kontratat do të lëshohen më së shumti një vjeçare dhe familjet do të duhet të aplikojnë për çdo vit.

Banimi individual

Komuna e Shtimes do të vazhdoj komunikimin me donatorë të ndryshëm të cilët janë të interesuar të ndihmojnë familjet të cilat kanë nevojë për banim që të ju ndërtohen/rinovohen shtëpi individuale. Kjo është forma më e qëndrueshme për të siguruar banimin për këto familje.

Komuna e Shtimes do të ofrojë informatat relevante dhe do të inicojë programe në këtë drejtim.

REZULTATET PAS ZBATIMIT

Programi për Banim është hartuar në mënyrë që të mund të zbatohet, të matet dhe të monitorohet. Monitorimi është një tipar i domosdoshëm për shkak se ai siguron që veprimet janë zbatuar dhe se përpjekjet janë duke u bërë për të siguruar përshtatjen me ndryshimet në burimet e disponueshme dhe të nevojshme.

Pas përfundimit të çdo projekti në mënyrë transparente do t'i komunikohet publikut.

Instrumentet e mbikqyrjes

Përgjegjës për realizimin e këtij programi është DSHMS. Kësaj drejtorie do t'i raporton zyrtari për banim social që planifikohet të emërohet si pjesë e këtij programi.

Zyrtari për Banim Social ka për detyrë që të zhvillojë aktivitetet e mirëmbajtjes, implementimin e programit të banimit dhe zhvillimin e programeve tjera duke përcjellë dhe analizuar në vazhdimësi situatën e banimit.

Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve

Burimet njerëzore:

Autoritetet kompetente: DSHMS përmes zyrtarit për Banim Social ka për detyrë të raportojë për të gjitha aktivitetet në fushën e banimit, në çdo 6 muaj Kuvendit të Komunës.

Të përcjellin të gjitha të dhënat lidhur me mundësitë e financimit nga programet e ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare.

Të planifikojnë buxhetin krahas buxhetit komunal dhe burimeve të tjera relevante nga fusha e banimit. Të përcjellin-monitorojnë situatën në vazhdimësi të banorëve të cilët janë pjesë e këtyre programeve dhe të tjera, varësisht nga zhvillimet në komunë, mundësitë e bashkëpunimit ndërkomunal për raste specifike.

Masat që janë marrë për respektimin e kuadrit ligjor

Kjo pjesë do të jetë në vazhdimësi pjesë e punës së autoriteteve komunale për të cilat do të zbatohet monitorimi dhe auditimi.

Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparencës

Publiku si sovrani i Komunës, do të ketë të drejtën të dijë mënyrën se si shpenzohen të ardhurat e komunës në tërësi dhe ato të programeve trevjeçare, në veçanti, e do të sigurohet duke përfshirë publikun në procesin e sigurimit të transparencës si:

- zhvillimin e takimeve konsultuese me publikun;
- bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit të publikut;
- bërjen publike të programeve dhe projekteve që përfshijnë ato
- sigurimit të pjesëmarrjes së publikut gjatë diskutimeve që organet përkatëse do të zhvillojnë për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve;
- bërjen e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vend njoftimet komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut;
- çdo masë tjetër e cila vlerësohet e nevojshme në përmbushje të këtij qëllimi.

ANALIZA SWOT

Përparësitë	Dobësitë- Mangësitë
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ekzistimi i Ligjit për finansimin e programeve të veçanta të banim (03/L-164) të përcjellë me shumë Udhëzime Administrative; 2. Përpilimi i këtij programi; 3. Caktimi i parcellës për ndërtim të një ndërtese par banim social; 4. Ekzistimi i Data Bazës për regjistrimin dhe monitorimin e aplikuesve për Banim Social; 5. Numri i aplikantëve momental që kanë kërkuar banim; 6. Vullneti komunal për trajtimin e temës së Banimit Social; 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përvoja e pamjaftueshme për banim social; 2. Mungesa e ndërtesave në pronësi të komunës që do të mund të përdorej për banim social; 3. Buxheti i paplanifikuar për 2020; 4. Kosto e lartë e banimit; 5. Buxheti limituar vjetor komunal;
Mundësitë	Rreziqet
<ol style="list-style-type: none"> 1. Emrimi i një zyrtari për Banim Social; 2. Lista e kërkuësve; 3. Interesimi i Qeverisë së Kosovës për të ndihmuar financiarisht; 4. Donatorët tjerë potencial; 5. Identifikimi i banesave private që mund të lëshohen për Bonus Banim; 6. Programe të përbashketa me partnerin d ndërkombetar në fushen ebanimit; 7. Zgjerimi i aktiviteteve përmes skemave të Partneritetit Publiko Privat; 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Jo stabiliteti politik; 2. Rritja e numrit të kërkesave; 3. Mosrealizimi i programeve për mungesë të fondeve; 4. Niveli i lartë i varfërisë; 5. Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare; 6. Papunësia; 7. Trendi i rritjes së numrit të popullsisë; 8. Migrimi



**KRYESUESJA E KUVENDIT
MEDINA BRAHAJ**